



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun



REPUBLIKA E KOSOVES	KOMUNA E RAHOVECIT
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES	KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES
Nr./Br./No. 993	Nr. i Fajës / N. i Fajës 146
Data/Datum/Date 12.7.23	RAHOVEC / ORAHOVAC

Data/Date:	12.7.2023
Nga/Od/From	Komitetit Komunal Veprues
Për/Za/To:	Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
CC	Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit, Defrim Kafexhiu
Tema/Subjekat/Subject	Raporti i konsultimit publik për Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare-Komuna Rahovec 2023-2025

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Ecuria e procesit të konsultimit publik për Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare-Komuna Rahovec-2023-2025

Kryetari i Komunës, më ka marrë vendim për themelimin e Komitetit Komunal Veprues për Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare-Komuna Rahovec 2023-2025, në këtë përbërje:

- Fatmir Iska, udhëheqës,
- Avni Morina, anëtar,
- Saranda Sallteku, anëtare,
- Lendrit Qeli, anëtar,
- Habibe Haxhimustafa, anëtare,
- Alban Gashi, anëtare,
- Përfaqësuesi nga OJQ "SHL Kosova" anëtar/e,
- Përfaqësuesi nga OJQ "SHPG Hareja", anëtar/e,
- Përfaqësuesi nga OJQ, "Geen-A", anëtar/e,
- Përfaqësuesi nga OJQ, "Këshilli Rinor i Rahovecit", anëtar/e.

Vendimi në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/01/LISTA-E-VENDIMEVE-java-e-trete-janar-2023.pdf>

Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare-Komuna Rahovec 2023-2025 u vu në konsultim publik më 22 qershor 2023 deri më 22 korrik 2023 ashtu siç parasheh Udhëzimi për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike.

1. Njoftimi: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Njoftim-konsultim-per-Planin-e-Veprimit-per-perfshirjen-e-Komunitetit-Rome-dhe-Ashkali-ne-shoqerine-kosovare.pdf>
2. Platforma Qeveritare për Konsultime Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41933>
3. Lajmi: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/u-mbajt-konsultimi-publik-per-planin-e-veprimit-per-perfshirjen-e-komunitetit-rome-dhe-ashkali-ne-shoqerine-kosovare-komuna-rahovec-2023-2025/>

Konsultimi Publik

Konsultimi Publik për Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare-Komuna Rahovec 2023-2025 u mbajtë më: 6.7.2023 në Sallën e Kuvendit Komunal Rahovec, me fillim nga ora 11:20.

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Takim i drejtpërdrejtë në Sallën e Kuvendit me banor dhe përfaqësues të komuniteteve në komunën e Rahovecit	6.7.2023 50 minuta	25 pjesëmarrës 15 femra	6 pjesëmarrës kanë parashtruar pyetje-3 komente, 1 e refuzuar, 1 gjysmë e pranuar, 1 e pranuar

Publikimi në ueb faqe / platforma elektronike	14 ditë para dëgjimit publik		Asnjë koment nuk kemi marrë
--	------------------------------------	--	--------------------------------

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komentete është i detyrueshëm)
Xhemalji Isaku: Përshëndetje për ju të pranishëm, unë e kam shtëpinë afër Rexhep Oruqi ndër shqetësimet tona është ndriçimi publik, mungesa për parkingje!	E pranuar	Lendrit Qeli, Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim: Përshëndetje për ju të pranishëm, te banimi nuk parashihet vetëm ndriçimi, mirëpo e gjithë infrastruktura. Të mungesa e parkingjeve shumë shpejtë do të zgjidhet si problem-do të merren masa për zgjerimin e parkingjeve.
Ram Berisha: Ju përshëndes të gjithëve, Komunitetet kanë nevojë për këto kushte që ju i përmendet gjatë prezantimit të Planit, si: arsim, banim, mirëqenie sociale etj.	E pranuar (koment)	

Bajram Morina: Përshëndetje për ju të pranishëm! Ju falënderoj për punën dhe angazhimin tuaj z. Lendrit Qeli. Sa i përket komponentëve të Arsimit dhe Punësimit, unë kërkoj që të ketë mbështetje më të madhe në krijimin e mundësive të punësimit për komunitete, sepse për shkak të mungesës së arsimit të fëmijëve edhe mundësit e punësimit janë të vogla. Po ashtu ju inkurajoj të motivoni fëmijët të vazhdojnë arsimimin.	E pranuar-koment	
Besmir Hasani: Përshëndetje për ju të pranishëm! Kisha propozua që të vendosen pengesat rrugore për arsye të vozitjes së shpejtë po rrezikohet edhe jeta e fëmijëve.	Gjysmë e pranuar	. Lendrit Qeli, Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim: Problemi i pengesave-nevoja me pas pengesa është shumë e madhe, kërkoj që edhe njëherë ta ritheksoni këtë problem edhe në KKSBB-ë.

Egzon Hamza, anëtar i KKSB-së: Përshëndetje për ju të pranishëm! Të banimi social, shumë nga ne janë me banim social, kërkesë e imja është me gjet mundësi buxhetore për sigurimin e ngrohjes me dru zjarri për dimër si dhe nevoja për parqe rekreative për fëmijë. Po ashtu të banimi social, sa komunitete mund të përfitojnë, pra sa është numri që mund të përfitojnë banim?	Refuzuar	Lendrit Qeli, Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim: Mbështetja me dru zjarri, ne si Zyre nuk kemi shumë buxhet-Të Investimet Kapitale-është alokuar kodi buxhetor për këtë drejtim, e gjitha varet nga Ministria e Financave me ndryshua këtë Kod.
Bajram Morina: Tash është afati i regjistrimit të fëmijëve në shkollë, andaj ju bëj Apel të gjithë prindërve që ti regjistrojnë fëmijët në shkollën fillore dhe gjimnaze.	Koment	

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendim për themelimin e Komitetit Komunal Veprues për Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare-Komuna Rahovec 2023-2025
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik
3. Lajmin për mbajtjen e konsultimit publik
4. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Rahovec, 12 korrik 2023

Qëndresa Duraku

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun





LISTA E NËNSHKRIMEVE TË QYTETARËVE PJESËMARRËS NË KONSULTIMIN PUBLIK PËR PLANIN I VEPRIMIT
PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETIT ROMË DHE ASHKALI NË SHOQËRINË KOSOVARE- KOMUNA
RAHOVEC
2023-2025

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nënshkrimi
1	VIAZIM HASANI	Hasani		Hasani
2	Benjamin	Hasani		B. Hasani
3	Blerim	Hasani		B. Hasani
4	Egon	Humo	Adminder KDR	Egon
5	Nelma	Isa	Arma	Nelma
6	Shyqenje	Humo	Arma	Shyqenje
7	Flake	Isa	Arma	Flake
8	Jovan Bozic	Bozic	ZYRTAR ZIKR	Jovan Bozic
9	ESVA MIRONIC	V. M.	Zyrtar për kërkim	V. M.
10	Stanoje Miro	M. C.	Z. K. K.	C. M.
11	Edonita	Perisha	Anëtare e Komunitetit për komunitet	Edonita
12	Nuriye	Ameyziu	Ashkali	Nuriye
13	Xhemile	Pogok	Ashkali	Xhemile
14			ROM	H - A
15	MYRISHA	ALUSHI		
16	Elizabeta	Hasani	Ashkali	Elizabeta
17	Adrijana	Kryeziu	Ashkali	Adrijana
18	Sedje	Gash	Ashkali	S. G.
19	Ermine	Bytyqi	Ashkali	E. B.
20				
21				
22				
23				

6.7.2023
Rahovec



LISTA E NËNSHKRIMEVE TË QYTETARËVE PJESËMARRËS NË KONSULTIMIN PUBLIK PËR PLANIN I VEPRIMIT
PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETIT ROMË DHE ASHKALI NË SHOQËRINË KOSOVARE- KOMUNA
RAHOVEC
2023-2025


Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nënshkrimi
1	SAMI R	SHALA	PRIVAT	Samir
2	Xhemaj	Jodan		
3	Rasna Boule	Komprakan		Rasna
4	IVANA	MOŠIĆ	ZYRTAR	IVANA
5	VIDICA	BURICIC	ZYRTAR	VIDICA
6	BLANKICA	MIRIC	ZYRTAR	BLANKICA
7	BRAMADAY			BRAMADAY
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				

6.7.2023
Rahovec



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality of Rahovec



Komuna e Rahovecit përmes grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Romë dhe Ashkali në shoqërinë kosovare-Komuna Rahovec 2023-2025, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr. 1005 i datës, 29.3.2017 dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Romë dhe Ashkali në shoqërinë kosovare-Komuna Rahovec 2023-2025

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga 22.06.2023 deri me datën 22.07.2023, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me 06.07.2023, në sallën e Kuvendit Komunal me fillim në ora 11:00.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datë 21.07.2023 në ora 16:00, në emailat e zyrtarëve: lendrit.qeli@rks-gov.net dhe dafina.b.gashi@rks-gov.net

Për më shumë detaje, për organizimin e konsultimit publik për Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Romë dhe Ashkali në shoqërinë kosovare-Komuna Rahovec 2023-2025, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Udhëfaqen zyrtare në rubrikën dokumente në konsultim publike:

<http://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/dokumente-ne-konsultim-publik/>


Platformën për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20529&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Facebook:

<https://www.facebook.com/rahoveckomuna?mibextid=LQQJ4d>

Mirë se vini!





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Onihovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine/Municipal Mayor

VESTESIM QY KOSOVË

Njësi Nr. 68 No. 68 Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr. Br. No. 68 Nr. i fag./Br. Nr. No. 101

Data/Date/Date 23.1.23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008"), Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022 - 2026 dhe Planit të Veprimit 2022 - 2024, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit Komunal Veprues (KKV)

- Me këtë vendim themelohet Komiteti Komunal Veprues (KKV) në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Fatmir Iska – Nënkyetari i Komunës, udhëheqës
 - 1.2 Avni Morina – Drejtor i Drejtorisë për Arsimit, anëtar
 - 1.3 Saranda Sallteku – Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare
 - 1.4 Lendrit Qeli – Udhëheqës i Zyrtës Komunalë për Komunitete dhe Kërkim, anëtar
 - 1.5 Habibe Haxhimustafa - Zyrtare për të drejtat e njeriut, anëtare
 - 1.6 Alban Gashi – Zyrtar për barazi gjinore, anëtar
 - 1.7 Ekrem Bytyqi – Zyrtar për Financa, anëtar
 - 1.8 Përfaqësuesi nga OJQ "SHL Kosova, anëtar
 - 1.9 Përfaqësuesi nga OJQ "SHPH Hareja", anëtar
 - 1.10 Përfaqësuesi nga OJQ "Geen – A", anëtar
 - 1.11 Përfaqësuesi nga OJQ "Këshilli Rinor i Rahovecit", anëtar
- Z. Lendrit Qeli caktohet Koordinator i Komitetit Komunal Veprues (KKV) në Komunën e Rahovecit.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteti Komunal Veprues (KKV) janë të përcaktuara në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022 - 2026 dhe Planit të Veprimit 2022 - 2024.
- Komiteti Komunal Veprues është i obliguar që të mbajë së paku 6 (gjashtë) takime në vitë dhe ftohen nga udhëheqësi i Komitetit Komunal Veprues (KKV) përmes koordinatorit të Komitetit Komunal Veprues (KKV).
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komitetit Komunal Veprues (KKV).
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01/752/18 i datës 26.7.2018, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01/43/19 i datës 6.2.2019.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të KKV-së,
- ZKKK-së,
- MAPL-së dhe
- Arkivit.

